




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit Prokurorial të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të KPK kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i Sekretariatit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Sekretariatit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesuesi është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Këshillit Prokurorial të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Këshillit Prokurorial të Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Këshillit Prokurorial të Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur një fushë për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, që është paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjes dhe rekomandimit. Kjo gjetje dhe rekomandim ka për qëllim të bëjë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e pasurive.

Ky raport ka rezultuar me një rekomandim. Ne do të përcjellim (shqyrtojmë) këtë rekomandim gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 6,138,167€, pasurive jokapitale është 343,048€, si dhe e stoqeve 9,994€.

Çështja B1 - Mbivlerësimi i pasurive kapitale

Gjetja

Sipas Rregullores nr. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 10, të gjitha pasuritë jo financiare pas pranimit në pronësi dhe mbikëqyrjes së organizatës buxhetore, pavarësisht a janë të paguara apo pjesërisht të paguara, duhet të regjistrohen në regjistrat kontabël dhe të jenë objekt i inventarizimit dhe i vlerësimit. Ndërsa sipas nenit 11.3, pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi.

Ne identifikuar se, projekti “Renovimi i objektit të Prokurorisë Speciale”, në vlerë prej 624,067€ figuronte në regjistrin e pasurisë si investim në vijim edhe pse pranimi përfundimtar i punëve për këtë objekt ishte bërë në prill 2023. KPK kishte filluar ta përdorë këtë objekt nga qershori i vitit 2023, kur edhe kishte pranuar faturën e situacionit të fundit.

Pagesa e situacionit të fundit nuk ishte kryer deri në fund të vitit për shkak të disa problemeve që ishin paraqitur me rastin e shfrytëzimit të objektit. Në mungesë të kësaj pagese, zyrtarët përgjegjës kanë vlerësuar që kjo pasuri duhet të vazhdojë të trajtohet si investim në vijim edhe pse objekti ishte në përdorim. Si rezultat i kësaj nuk është aplikuar zhvlerësimi, duke mbivlerësuar vlerën e pasurisë për 10,401€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos kryerjes së punës me kompetencë profesionale nga ushtruesi i detyrës së zyrtarit të pasurisë. Kjo pozitë mbahej me ushtrues detyre që nga viti i kaluar.

Ndikimi

Regjistrimi i pasurive në përdorim si investime në vijim ka pamundësuar aplikimin e shpenzimeve të zhvlerësimit, duke e mbivlerësuar vlerën e pasurive për shumën e njëjtë. Kjo ka ndikuar që informatat e paraqitura në PVF të mos jenë të sakta.

Rekomandimi B1

Kryesuesi i KPK-së duhet të sigurojë se pasuritë të cilat janë pranuar teknikisht dhe janë në përdorim, të evidentohen në regjistrin e pasurisë si pasuri në përdorim, duke aplikuar edhe shpenzimet e zhvlerësimit, me qëllim të paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PVF. Po ashtu, Kryesuesi i KPK-së duhet të sigurohet se pozita e zyrtarit të pasurisë mbulohet me staf të rregullt.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	15,913,983	14,801,554	14,143,932	13,419,514	13,324,362
Grante Qeveritare - Buxheti	15,913,983	14,801,547	14,143,932	13,419,514	13,324,362
Donacionet e jashtme	0	7	0	0	0

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 1,112,428€, si rezultat i kursimeve buxhetore me vendime të qeverisë.

Në vitin 2023 OB ka shpenzuar 96% të buxhetit përfundimtar në 2023 ose 14,143,932€, me një përmirësim prej 4% në krahasim me vitin 2022.

Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	15,913,983	14,801,554	14,143,932	13,419,514	13,324,362
Pagat dhe mëditjet	11,505,353	10,892,917	10,892,600	10,627,301	10,592,055
Mallrat dhe shërbimet	2,720,000	3,011,212	2,892,947	2,308,176	2,054,132
Komunalitë	199,630	199,630	132,589	117,342	115,310
Investimet Kapitale	1,489,000	697,795	225,795	366,695	562,864

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 612,436€. Ndryshimet kanë ndodhur si rezultat i vendimit të qeverisë nr.69/2023 për transferimin e mjeteve buxhetore për mbulimin e shpenzimeve të pagave të muajit dhjetor në institucionet që kishin munges të mjeteve në këtë kategori. Shpenzimet në këtë kategori ishin 100% e buxhetit final;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 291,212€. Ndryshimet kanë ndodhur si rezultat i transferit të mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në bazë të këtyre vendimeve: vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm nr.307/2023 të miratuar nga MFPT për transferin e mjeteve në vlerë 74,301€ për mbulimin e shpenzimeve të sigurimit sipas marrëveshjes në mes të KPK-së dhe Policisë së Kosovës; si dhe vendimit të qeverisë nr.16/174, për transfer të 79,000€ dhe vendimit Nr.525/2023 për transfer të 137,904€ për mbulimin e shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe furnizimeve në programin Prokuroritë dhe Administrata. Shpenzimet në këtë kategori ishin 96% e buxhetit final;
- Buxheti final për shërbime komunale krahasuar me buxhetin fillestar ishte i njëjtë. Shpenzimet në këtë kategori ishin 66% e buxhetit final; si dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 791,205€. Zvogëlimi ka ndodh si rezultat i mosrealizimit të disa projekteve të rëndësishme si: projekti "Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike të sistemit prokurorial" i cili nuk ishte realizuar për shkak se Kuvendi Komunal i Prizrenit nuk ka mundur ndarjen e një parcele për ndërtimin e objektit të KPK-së afër Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prizren; projekti "Blerja e Tokës për Prokurorin Themelore në Mitrovicë" nuk është realizuar po ashtu për shkak të vështirësive në ndarjen e një parcele nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës së Veriut dhe kjo ka pamundësuar ndërtimin e objektit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte vetëm 32%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga KPK në vitin 2023 ishin në vlerë 47,760€. Ato mblidhen për fondin për kompensimin e dëmit të viktimave të veprave penale.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	18,809	18,809	47,760	11,330	16,245
Të hyrat jo tatimore	18,809	18,809	47,760	11,330	16,245

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të KPK ka rezultuar në një rekomandim. KPK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do ta zbatoj rekomandimin e dhënë. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, rekomandimi nuk ishte zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasuritë	Kryesuesi i KPK-së duhet të sigurojë se pasuritë të cilat nuk janë pranuar teknikisht dhe nuk janë vënë në përdorim të evidentohen në regjistrin e pasurisë si investime në vijim, në përputhje me kërkesat e rregullores së pasurisë	Rekomandimi nuk është zbatuar, pasi që edhe gjatë vitit 2023 kemi identifikuar pasaktësi në vlerën e pasurisë. Sa i përket të gjeturës së vitit të kaluar tek pasuritë, ne kemi konfirmuar përmirësimin e gabimit në regjistra.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit




Albana Kadriu, Udhëheqëse e ekipit



Aurora Morina, Anëtare e ekipit



Shefkije Beka, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mbivlerësimi i pasurive kapitale	<p>1. Renovimi i objektit të Prokurorisë Speciale në vlerë prej 647,311.07€ deri në dhjetor të vitit 2023 ka qenë i regjistruar si investim në vijim. Më 8 dhjetor 2024 është gjeneruar raporti i pranimit sipas faturës së fundit në SIMFK. Më 11 dhjetor 2023 është bërë pagesa e faturës së fundit të këtij projekti, me çka edhe përmbyllet ky projekt kapital.</p> <p>Regjistrimi i këtij projekti kapital nga investimi në vijim bëhet si regjistrim i pasurisë nga data 8 dhjetor 2023, data kjo, kur edhe është lëshuar raporti i pranimi në SIMFK.</p> <p>Meqenëse, ky projekt është përmbyllur dhe paguar në dhjetor të vitit 2023, regjistrimi i kësaj pasurie bëhet nga data 8 dhjetor 2023 dhe, sipas Rregullores nr. 02/20 13 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, zhvlerësimi i kësaj pasurie fillon nga muaji vijues i regjistrimit të pasurisë. Përkatësisht, zhvlerësimi i kësaj pasurie fillon nga janar i vitit 2024, meqë muaji dhjetor 2023 kur bëhet regjistrimi nuk aplikohet zhvlerësimi.</p> <p>Duke ju referuar Rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Udhëzimit të brendshëm Administrativ nr. 03/2018 për menaxhimin e pasurisë jo financiare të Këshillit Prokurorial të Kosovës, bazuar në raportin e pranimit dhe të pagesës së faturës së fundit të projektit kapital, si dhe udhëzimeve edhe nga Thesari, në SIMFK është bërë regjistrimi i kësaj pasurie nga 8 dhjetor 2023 dhe zhvlerësimi do të aplikohet nga janari i vitit 2024.</p> <p>Në PVF të vitit 2023, vlera a pasurisë është e saktë dhe nuk ka</p>	<p>1. Ne analizuam komentin e KPK-së sa i përket çështjes B1- Mbivlerësimi i pasurive kapitale si dhe kërkesës së KPK-së drejtuar Thesarit. Përgjigja e Thesarit ka qenë e saktë karshi pyetjes së Zyrtares së KPK-së. Në pyetje nuk kanë qenë të detajuara informatat që ne i kemi paraqitur në gjetjen tonë, e që kanë të bëjnë me pranimin teknik të pajisjes që ka ndodhur në prill të vitit 2023, faturën e pranuar në qershor 2023 dhe shfrytëzimin e objektit nga muaji qershor. Bazuar në këto informata do të ndryshonte edhe përgjigja e Thesarit.</p> <p>Duke marrë parasysh të gjitha këto fakte, ne konsiderojmë se nga momenti i pranimit teknik, pasuria i përmbush kriteret e njohjes së pasurisë sepse entiteti ka kontroll mbi pasurinë, që nënkupton aftësinë për të drejtuar përdorur dhe për të marrë përfitimet prej saj. Pjesa e vonesës në pagesë ka mundur të shpaloset, mirëpo jo të ndikojë që pasuria mos të regjistrohet në regjistra si pasuri në përdorim.</p> <p>2. Komenti i KPK-së sa i përket statusit të rekomandimit të vitit të kaluar, ne e kemi konfirmuar saktësinë e regjistrimit sa i përket gjetjes së vitit paraprak sepse në të kundërtën kjo do të trajtohej edhe në raportin e këtij viti. Përkundër kësaj, edhe këtë vit ne kemi konstatuar pasaktësi në regjistrin e pasurisë dhe duke u bazuar në këtë, ne kemi konsideruar që rekomandimi për saktësi të regjistrimit të pasurive nuk është zbatuar.</p>

mbivlerësim të pasurisë, sepse zhvlerësimi i pasurisë për projektin kapital "Renovimi i objektit të Prokurorisë Speciale" fillon nga janari i vitit 2024 që do të thotë se nuk e ka asnjë efekt në vlerë të pasurisë kapitale në PVF të vitit 2023.

Andaj, bazuar në procesin e regjistrimit të pasurisë, sipas akteve nënligjore për menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe udhëzimeve të Thesarit, nuk qëndron çështja e ngritur në Draft raportin e auditimit të ZKA-së "Mbivlerësimi i pasurive kapitale".

2. Sipas draftit të Raportit të Auditimit të ZKA-së, "rekomandimi nuk është zbatuar, pas që edhe gjatë vitit 2023 kemi identifikuar pasaktësi në vlerën e pasurisë", si dhe nuk qëndron statusi "nuk ka filluar zbatimin".

KPK-ja ka hartuar Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimit të auditimit për vitin 2022.

Është dërguar shkresa në Thesar dhe është bërë regjistrimi i pasurisë nga pasuria në investim në vijim.

Për zbatimin e këtij rekomandimi kemi dërguar edhe raportin tek ZKA-ja dhe grupi i auditorëve të ZKA-së ka bërë verifikimin e zbatimit të këtij rekomandimi, sipas dëshmimeve përkatëse për secilën fazë të këtij procesi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës - Tužilački Savet Kosova - Kosovo Prosecutorial Council

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), për vitin 2023 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- nuk pajtohem me gjetjen dhe rekomandimin. Komentet dhe dëshmitë e dokumenteve në lidhje me të gjeturën, për të cilën nuk pajtohem, janë të bashkangjitura me këtë letër konfirmimi;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Samir Istrefi

Drejtor i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës,

Data: 22.04.2024, Prishtinë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.